

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr.06/2011

1 Mars 2012

Trupi Gjykses i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Nikolay Entchev, si Kryetar i Trupit Gjykses, Gjyqtari Beqir Halili dhe Gjyqtarja e EULEX-it Katja Dominik, si anëtarë të trupit gjykses, në lëndën penale kundër:

Samedin Ismajli, i akuzuar për Vrasje të Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147 Pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK, dhe për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posesim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës, në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi 2 i KPK;

Avdyl Ismajli, i akuzuar për Vrasje të Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147 Pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK, dhe për Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posesim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës, në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi 2 i KPK; dhe

Januz Ismajli, i akuzuar për Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147, pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenin 25, paragrafi 1 dhe 2 i KPK,

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor gjyqësor, të hapura për publikun, më datë 8, 9, 10, 27, 28, 29 Shkurt dhe 1 Mars 2012, që të gjitha në prani të të tre të akuzuarve, avokatit mbrojtës Pashe Kuci për Samedin Ismajlin, Isa Osdautaj për Avdyl Ismajlin dhe Gani Rexha për Januz Ismajlin, Prokurorëve Publik të EULEX-it Nancy Casas më 8 Shkurt dhe Adebayo Kareem në seancat tjera, Palëve të dëmtuara Fadil Xani, Adnan Koci dhe Jusuf Hoti më 8, 9 dhe 10 Shkurt; pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykses, të mbajtur me datë 1 Mars 2012, të njëjtën ditë, në pajtim me Nenin 392, Paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli publikisht dhe në prani të të akuzuarve të lartë-cekur, Avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Publik të EULEX-it, këtë:


AKTGJYKIM

D) Samedin Ismajli, i biri i Mehmet Ismajlit dhe Elifije Gllarevës, i lindur më 18 Maj 1984 në Skenderaj, me vendbanim të përhershëm në Klinikë të Poshtme, Komuna Skenderaj,

SHPALLET FAJTOR

(A)

Sepse më datë 24 Qershor 2010 rreth orës 08.40, i pandehuri, në bashkëkryerje me Avdyl Ismajlin, ka shtëne disa herë me armë zjarri të llojit të panjohur, të kalibrit 7.62 x 25 në drejtim të palëve të dëmtuara Fadil Xani, Adnan Koca dhe Isuf Hoti me qëllim të privimit të tyre nga jeta. Të shënat kishin ndodhur brenda në Kuvendin Komunal në Skenderaj, gjatë orarit të punës, në korridor ku gjindet hyrja në zyrën nr. 4, gjerësa të tri palët e dëmtuara po afroreshin te hyrja e



asaj zyre me qëllim të marrjes së një certificate per bartjen e patundshmërisë. Persona të tjerë ishin të pranishëm në afërsi të vendit ku kishin ndodhur të shtënat me armë.

Si rezultat i të shtënave, ishin plagosur të tri palët e dëmtuara, përkatësisht: Isuf Hoti kishte marrë dy plagë: në kokë dhe në krahëror të cilat e kishin lënduar rëndë atë dhe kishin rrezikuar jetën e tij; plaga në kokë ka rezultuar me humbje të përhershme të syrit të majtë të tij; Adnan Koca kishte marrë tri plagë, një në krahëror, një në pjesën lumbale dhe një në pjesën e gjurit të djathtë të cilat e kishin lënduar rëndë atë dhe kishin rrezikuar jetën e tij; Fadil Xani kishte marrë një plagë në këmbën e tij të majtë.

Motivi i veprimit kriminal të të pandehurit është një kontest me palët e dëmtuara lidhur me pronësinë e patundshmërisë së lartë-cekur. Pas të shtënave, i pandehuri ishte larguar nga vendi i ngjarjes dhe kishte ikur në drejtim të panjohur.

Duke vepruar kështu, i pandehuri, në bashkëkryerje me Avdyl Ismajlin, kanë kryer dhe janë penalisht përgjegjës për veprën penale Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147 Pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK.

Gjithashtu, i pandehuri

SHPALLET FAJTOR

(B)

Sepse në ditën, vendin dhe orën e njëjtë si në pikën A të dispozitivit, i pandehuri kishte përdorur në mënyrën e cekur më lartë armën e llojit të panjohur, e kalibrit 7.62 x 25 pa leje të vlefshme,

Duke vepruar kështu, i pandehuri ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posesim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës**, në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi 2 i KPK;

II)

Avdyl Ismajli, i biri i Muhamet Ismajlit dhe Hasime Maksutit, i lindur më 13 Korrik 1987, në Skenderaj, me vendbanim të përhershëm në Klinë të Poshtme, Komuna e Skenderajt,

SHPALLET FAJTOR

(A)

Sepse më 24 Qershor 2010 rreth orës 08.40, i pandehuri, në bashkëkryerje me Samedin Ismajlin, ka shtënë disa herë me armë zjarri të kalibrit 7.62 x 25 në drejtim të palëve të dëmtuara Fadil Xanit, Adnan Kocit dhe Isuf Hotit me qëllim të privimit të tyre nga jeta. Të shtënat kishin ndodhur brenda në Kuvendin Komunal në Skenderaj, gjatë orarit të punës, në korridor ku gjindet hyrja në zyrën nr. 4, gjerësa të tri palët e dëmtuara po afroheshin te hyrja e asaj zyre me qëllim të



marrjes së një certifikate për bartjen e patundshmërisë. Në afërsi të vendit ku kishin ndodhur të shtënat me armë kishte edhe persona tjerë të pranishëm.

Si rezultat i të shtënave, ishin plagosur të tri palët e dëmtuara, përkatësisht: Isuf Hoti kishte marrë dy plagë: në kokë dhe në krahëror të cilat e kishin lënduar rëndë dhe ia kishin rrezikuar jetën; plaga në kokë ka rezultuar me humbje të përhershme të syrit të majtë të tij; Adnan Koca kishte marrë tri plagë, një në krahëror, një në pjesën lumbale dhe një në pjesën e gjurit të djathtë të cilat e kishin lënduar rëndë dhe ia kishin rrezikuar jetën; Fadil Xani kishte marrë një plagë në këmbën e tij të majtë.

Motivi i veprimit kriminal i të pandehurit është një kontest me palët e dëmtuara lidhur me pronësinë e patundshmërisë së lartë-cekur. Pas të shtënave, i pandehuri ishte larguar nga vendi i ngjarjes dhe kishte ikur në drejtim të panjohur.

Duke vepruar kështu, i pandehuri, në bashkëkryerje me Samedin Ismajlin, kanë kryer dhe janë penalisht përgjegjës për veprën penale Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147 Pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenet 20 dhe 23 të KPK.

Gjithashtu, i pandehuri

SHPALLET FAJTOR

(B)

Sepse gjatë një periudhë të panjohur kohore deri më 24 Qershor 2010, pa autorizim, ishte në posedim të një pistolette "CZ model 52" me numër serik "M 09385", e kalibrit 7.62 x 25; dhe në të njëjtën ditë, vend dhe orë si në Pikën A të dispozitivit, i pandehuri kishte përdorur armën e njëjtë në mënyrën e lartë-cekur.


Duke vepruar kështu, i pandehuri ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale **Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posesim apo Përdorim të Paautorizuar të Armës**, në kundërshtim të Nenit 328, Paragrafi 2 i KPK;

(III)

Januz Ismajli, i biri i Sylë Ismajlit dhe Zoja Ibrahimit, i lindur më 1 Maj 1950 në fshatin Klina e Poshtme, ku edhe banon

SHPALLET I PAFAJSHËM

Sepse nuk është vërtetuar se i pandehuri kishte kryer veprën për të cilën akuzohet. Përkatësisht, nuk është vërtetuar se i pandehuri u kishte premtuar Samedin dhe Avdyl Ismajlit se do tu ndihmonte duke e fshehur mjetin e kryerjes së veprës penale dhe identitetin e kryerësve të krimit, apo duke siguruar ikjen e tyre nga vendi i ngjarjes, dhe as nuk vërtetohet se ai ju ka ndihmuar



atyre të ikin nga vendi i ngjarjes duke i lejuar ata të kërcejnë nga dritarja e zyrës së tij në Kuvendin Komunal të Skenderajt, duke përdorur një veturë Mercedes që të largohen nga afërsia e ndërtesës së komunës dhe duke fshehur gjurmët e krimit nga rrobet e Samedin dhe Avdyl Ismajlit.

Andaj, në përputhje me nenin 390 pika 3 e KPPK, i akuzuari lirohet nga akuza Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë, në kundërshtim të Nenit 147 Pikat 4 dhe 11, lidhur me Nenet 25, paragrafi 1 dhe 2 i KPK.

DËNIMI

Samedin Ismajli

DËNOHET

- me nëntë (9) vjet burgim për veprimin kriminal Vrasje e Rëndë në Tentativë
- me një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim për veprimin kriminal Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve

Dënimi unik caktohet në kohëzgjatje prej nëntë (9) vjet e nëntë (9) muaj burgim sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 09 Korrik 2010 do të llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

I pandehuri do ti kompenzojë 261 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale, duke përfshirë shpenzimet e ekspertit në cilësinë e dëshmitarit dhe duke përjashtuar shpenzimet e përkthimit gojor dhe me shkrim, sipas Nenit 102 Paragrafi (1) I KPPK.


Avdyl Ismajli

DËNOHET

- me nëntë (9) vjet burgim për veprimin kriminal Vrasje e Rëndë në Tentativë
- me dy (2) vjet burgim për veprimin kriminal Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi unik caktohet në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vjet burgim sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 09 Korrik 2010 do të llogaritet sipas Nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.



Pistoleta e tipit “CZ model 52” me numër serik “M 09385”, e kalibrit 7.62 x 25 konfiskohet sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i KPK.

I pandehuri do ti kompenzojë 261 Euro për pjesën e tij të shpenzimeve të procedurës penale, duke përfshirë shpenzimet e ekspertit në cilësinë e dëshmitarit dhe duke përjashtuar shpenzimet e përkthimit gojor dhe me shkrim, sipas Nenit 102 Paragrafi (1) I KPPK.

Januz Ismajli lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës pasi që ai është liruar nga të gjitha akuzat.

Sipas Nenit 112 par. 2 i KPPK, palët e dëmtuara udhëzohen që kërkesat pasurore mund t'i realizojnë në kontest civil.

Procesmbajtësi
Francesco de Sanctis

Kryetari i Trupit Gjykes
Nikolay Entchev

